



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

#### **Procesverbal nga mbledhja e XXXIII-të (tridhjetë e tre – mandati VI) e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 19 prill 2021**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10;10.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi znj. Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Bashkim Sylja, Doruntina Hasani, Valmire Lahu, Mefail Rama, ndërsa mungoi Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin, Driton Veliu, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, Bashkim Bajrami nga Policia Rajonale Kufitare

#### **Rendi i ditës**

**znj. Albina Avdiu**, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i falënderuar për pjesëmarrje në këtë mbledhje, ndër të tjera shtoi, thirrjen dhe materialin e kësaj mbledhje e keni marr me kohë, po ashtu edhe propozim planin e punës së Komitetit për vitin 2021 të cilin jua kam dërguar pas thirrjes së mbledhjes, andaj mund të vazhdojmë me rendin e ditës, nëse nuk keni diçka për të shtuar unë e hedh në votim.

*Njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës duke përfshirë edhe propozim planin e punës së Komitetit për vitin 2021, i dërguar nga Kryesuesja e Komitetit.*

#### **1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete të mbajtur më 03 mars 2021**

*Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim – ndryshime u miratua Procesverbali sipas kësaj pike.*

## **2. Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me gjendjen e krijuar nga Pandemia covid-19, gjendjen ekonomike sociale, me theks familjeve të komunitetit jo shumicë në Komunën e Podujevës**

**z.Driton Veliu**, drejtor i DSHMS, e paraqiti Informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, që nga fillimi i pandemisë, në Komunën e Podujevës i kemi gjithsej 3965 raste të infektimit me covid-19, prej tyre 3469 raste të shëruara, 444 raste aktive dhe 52 raste të vdekjes, pra ky është raporti i përgatitur para 2-3 ditësh, ndërsa sot kemi shifra tjera sepse ka ndryshime për çdo ditë.

Javën e fundit kemi rënie të kërkesave për teste rapide dhe PCR, arsyeja është sepse kemi rënie të rasteve me covid-19 në nivel nacional.

Sa i përket sektorit social, ne kemi ofruar ndihmë me pako të ndryshme, sidomos të ofruara nga donacionet e ndryshme, nga nesër fillon shpërndarja edhe e 400 pakove të cilat janë donacione nga Shoqatat ” Islamic Relief” dhe “Qatar Charity” kurse ditëve në vijim presim edhe donacione të tjera. Sa i përket komuniteteve jo shumicë, ne kërkojmë që edhe komunitetet jo shumicë të parashtrajnë kërkesa për ndihma sepse zakonisht kohëve të fundit jemi duke marrë listat e rasteve sociale prej Qendrës për Punë Sociale – QPS, por kemi edhe kërkesa direkte në DSHMS të cilat parashtrohen për ndihma me pako ushqimor, veshmbathje etj të ngjashme por edhe për subvencione për barna, dhe në këtë aspekt jemi duke shqyrtuar të gjitha kërkesat në mënyrë që numri i familjeve të komuniteteve të jetë shumë më i madh se sa që është tani sa i përket shpërndarjes së ndihmave, por ne gjithashtu lusim të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve që të komunikojnë me lagjet dhe komunitetet që i takojnë atyre në mënyrë që t’i njoftojnë ata për aplikimet që duhet bërë në DSHMS për ndihma të ndryshme duke përfshirë edhe kërkesat për shtëpi banimi, mirëpo sa i përket shtëpive të banimit ne kemi shumë problem për t’iu siguruar strehim përmes donatorëve për shkak se shumica e familjeve të komuniteteve jo shumicë që kanë nevojë për strehim dhe banim kanë problem me prona, dhe kur po iu ofrohet donatorëve ata po kanë hezitim për shkak se nuk kanë prona të tyre, por pavarësisht kësaj ne jemi në komunikim edhe me donatorë tjerë të ndryshëm në mënyrë që të gjejmë ndonjë mundësi për ndonjë investim më afatgjatë, qoftë me blerje të ndonjë prone për ndërtim të ndonjë banimi kolektiv qoftë forma tjera të cilat do të mund ta zbutshin gjendjen e strehimit për një numër të familjeve të komuniteteve jo shumicë.

Pra kjo është informata në pika të shkurtra, këtu jemi për ndonjë sqarim apo shpjegim shtesë, por si do që të jetë sërish kërkoj nga të gjithë që t’i njoftojnë përfaqësuesit dhe familjarët e komuniteteve jo shumicë që të parashtrajnë kërkesa për ndihmë në DSHMS, e që nuk po e bëjnë një gjë të tillë, kurse ne po duhet të marrim lista të atyre që janë me gjendje sociale dhe t’i përzgjedhim e që nuk është e lehtë një gjë e tillë sepse kemi shumë raste që janë sociale, dhe jo vetëm në komunitetet jo shumicë.

**znj.Doruntina Hasani**, theksoi, pyetje për drejtorin e DSHMS-së, a ka ndonjë strategji se si t’i sensibilizojnë komunitetet jo shumicë se si të aplikojnë dhe të parashtrajnë kërkesa për ndihma të ndryshme qoftë nga donatorët qoftë nga vetë komuna, në mënyrë që të vërehen dhe evidentohen rastet të cilat janë me gjendje më të keqe.

**z.Driton Veliu**, drejtor i DSHMS, theksoi, ne jemi duke komunikuar në mënyrë institucionale me QPS-së dhe atyre iu kemi kërkuar që të jetë numri sa më i madh i atyre që kërkojnë ndihma dhe që janë raste sociale, për komunitetet jo shumicë është fjala, mirëpo ne gjithashtu duhet të kemi kontakte edhe me përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në mënyrë që ata t’iu sqarojnë familjeve që të paraqesin kërkesa. Pra nuk bëhet fjalë që nuk kanë nevojë për ndihma por nuk po parashtrohen kërkesa, ndërsa ne duhet t’i inkurajojmë ata që të parashtrajnë kërkesa.

**z.Benjamin Ejupi**, theksoi, fillimisht falënderoj drejtorin parafolës të DSHMS për gatishmërinë dhe informata e dhëna. Për shkak të pandemisë, këtyre ditëve kemi vërejtur se vizitat tona si Komitet në terren kanë qenë të mangëta, arsyet dihen sepse jemi në situatë pandemie, mirëpo tani kemi propozim planin e punës të cilin besoj se do ta miratojmë në pikën e radhës, na obligon pak më shumë që të dalim në terren dhe ndoshta të kemi mundësi t'i vetëdijesojmë drejtpërsëdrejti komunitetet jo shumicë që të parashtrorjnë kërkesa në Komunë sepse tani e tutje këto gjëra rregullohen në mënyrë institucionale. Natyrisht dihet se të gjitha rastet kanë nevojë por të mundohemi që prej të gjitha atyre rasteve të gjejmë ato që kanë më shumë nevojë, andaj në këtë aspekt ndoshta neve na takon që t'i vizitojmë drejtpërdrejtë komunitetet dhe t'i njoftojmë ata se duhet parashtruar kërkesa për ndihma të ndryshme.

**z.Driton Veliu**, drejtor i DSHMS, theksoi, pajtohem me parafolësin dhe mendoj se do të ishte mirë që edhe Ju si Komitet t'i vizitoni, të komunikoni dhe t'iu bëni thirrje që familjet e komuniteteve jo shumicë të parashtrorjnë kërkesa në Komunë-DSHMS.

**znj.Albina Avdiu**, Kryesuese e Komitetit, theksoi, shpresoj se gjatë muajit të ardhshëm do të dalim edhe në vizita në terren, konkretisht në lagjet dhe fshatrat ku banojnë familjet e komuniteteve jo shumicë.

**z.Benjamin Ejupi**, theksoi, gjithashtu jemi në dijeni se gjatë muajit të Ramazanit ka shumë Organizata të cilat dhurojnë pako ushqimore për familjet në nevojë, andaj do të kërkoja nga DSHMS që të mos lihen anash familjet e komuniteteve jo shumicë për arsye se jemi në dijeni për gjendjen e tyre ekonomike dhe sociale.

**z.Driton Veliu**, drejtor i DSHMS, theksoi, unë e ceka se tani për tani ne vetëm në mënyrë institucionale jemi duke i përzgjedh përmes QPS-së familjet e komuniteteve jo shumicë që kanë nevojë për ndihma të ndryshme, mirëpo ne po kërkojmë edhe direkt nga komunitetet që të paraqesin kërkesa në mënyrë që ta rrisim edhe më shumë numrin e atyre që do të jenë përfitues të ndihmave me pako, por edhe me subvencione për barna për çka kemi një numër të madh të atyre që kanë nevojë. Unë kam parë që vijnë familje të njëjta nga dy-tri herë dhe bëjnë kërkesa për ndihmë, por në fakt ka edhe shumë e shumë tjerë që nuk kanë marrë fare për shkak të mungesës së informatave, prandaj edhe po kërkoj të informohen sa më shumë komunitetet jo shumicë ngase sidomos gjatë muajit të Ramazanit presim që do të ketë më shumë donatorë që do të ofrohen për të dhënë ndihma, me theks pako ushqimore në vlera të ndryshme 50-60 euro, por edhe donatorë të cilët jepin direkt ndihma atyre familjeve që ua caktojmë ne, shembull ne u caktojmë 8 ose 7 familje të komunitetit shumicë dhe 2 ose 3 familje të komunitetit jo shumicë.

Pra kemi gatishmëri të plotë t'i dalim në ndihmë komuniteteve jo shumicë.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, mendoj se për këtë temë koordinimi më shumë duhet të jetë mes DSHMS dhe Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, duke mos përjashtuar edhe përfaqësuesit e lagjeve përkatëse të cilët mund t'ju ndihmojnë shumë sa i përket familjeve me nevoja ekonomike sociale, kështu që edhe ne si Komitet për Komunitete mund t'ju ndihmojmë në këtë aspekt dhe mund të dalim në terren, mirëpo sa i përket kësaj çështje sërish e them se ZKKK do t'ju ndihmonte më së shumti juve si Drejtori, sepse ajo mban të gjitha listat dhe shënimet përkatëse se kush ka nevojë më shumë e kush më pak për ndihma.

**z.Driton Veliu**, drejtor i DSHMS, theksoi, ne si DSHMS jemi të gatshëm për bashkëpunim, veç duhet të na ofrohen bashkëpunime. Unë kam vërejtur shumë mangësi sa i përket mekanizmave që ndërlihen me komunitetet jo shumicë, qoftë për ndihma me pako, qoftë me subvencione, ndërsa se a duhet të përmirësohet kjo mendoj se po, por duhet të kemi koordinim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm sepse nuk mjaftojnë vetëm listat që i kërkojmë ne nga QPS por ka edhe shumë familje tjera që kanë nevoja të ndryshme.

Unë po e ritheksoj se ish bërë traditë, nëse mund ta quaj kështu, që të njëjtat familje, qoftë të komitetit shumicë qoftë jo shumicë, po aplikonin për ndihma, sikur të jenë të lidhura mes vete dhe të kenë një grup, ndërsa ne kemi identifikuar shumë më shumë familje të cilat kanë shumë më shumë nevojë se sa ata që parashtrajnë kërkesa. Nuk kam informata se si janë të organizuar komunitetet jo shumicë nëpër lagje që janë, por mendoj se ata duhet ta kenë një përfaqësues të lagjes në mënyrë që ne të flasim me 1 apo 2 prej tyre për të qenë në dijeni për gjendjen aktuale.

Po ashtu edhe sa i përket banimit kemi shumë probleme sepse janë disa familje të komitetit jo shumicë që janë në gjendje shumë të rëndë për të cilat kam biseduar me donatorë të ndryshëm por krejt problemi qëndron tek pronat, ne si Komunë nuk kemi të drejt të blejmë prona, donatorit si ti thuhet nuk ka pronë ai e lë krejt dhe nuk merret më me atë çështje, ndërsa në qoftë se vije ndonjë donatorë potencial i cili do të bënte zgjidhje kolektive apo të ngjashme është çështje tjetër, mirëpo për momentin nuk e kemi një ofertë të tillë.

Kryesuesja e Komitetit, falënderoj parafolësit për kontributin e dhënë dhe i'a kaloj fjalën shefit të ZKKK për informata dhe detaje tjera rreth kësaj teme.

**z.Liman Zeqiri**, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK, theksoi, falënderoj drejtorin e DSHMS-së për prezencën dhe informatat e dhëna për këtë temë e cila është e rëndësishme por edhe njëkohësisht edhe e ndjeshme. Natyrisht se informatat çdo herë kanë ekzistuar dhe ekzistojnë sa i përket çështjeve të ndërlidhen me Komunitetet jo shumicë në Komunën e Podujevës dhe për një gjë të tillë falënderoj të gjithë kolegët nga të gjitha drejtoritë e Komunës sepse në bazë të eksperiencës 15 vjeçare që kam gjithherë kemi pasë bashkëpunim dhe koordinim mes vete.

Jemi në situatë pandemike, sëmundje e cila e ka kapluar botën dhe natyrisht se në këto raste të gjithë duhet t'iu dalim në ndihmë njëri tjetrit dhe në këtë kontekst ne si Komunë kemi ndihmuar shumë me aq mundësi dhe kapacitete sa kemi, qoftë në kuptimin shëndetësorë qoftë në kuptimin human kur kemi parasysh se situata ekonomike është e rënduar në gjithë vendin.

Në bazë të evidencës që kam nga QPS, janë 77 familje me 422 anëtarë (ashkalinj 72 familje me 386 anëtarë dhe komuniteti rom me 5 familje dhe 36 anëtarë) dhe në bazë të dhënave dhe koordinimit që kemi me QPS-në dhe me DSHMS-sektorin për çështje sociale kemi raste ku është intervenuar edhe me nga dy herë me ndihma pako ushqimore dhe në këtë aspekt po ju informoj se në bazë të informatave dhe evidencave që kemi nga QPS ndoshta edhe tejkalohej numri i të ndihmuarve andaj nuk mund të thuhet se nuk janë ndihmuar familjet e komitetit jo shumicë, e them këtë sepse vetëm nga muaji janar e deri më sot më 19 prill 2021 janë ndihmuar me pako ushqimore 150 familje të komitetit jo shumicë, çështje kjo e cila shtynë secilin që të falënderoj institucionet komunale, pastaj kemi 3 familje të cilat janë ndihmuar me mjete financiare, mirëpo është shumë e arsyeshme ajo që drejtori i DSHMS-së e potencoj sepse ka shumë perona apo familje të cilat nuk dinë të bëjnë ndoshta e dhe kërkesë ngase duhet pasur një dokumentacion të kompletuar kur bëhet fjalë për rastet shëndetësore që duhet të ndihmohen me mjete financiare që sado pak t'iu lehtësohet jeta. Po ashtu është intervenuar edhe te 9 familje me ndihmë – dru për ngrohje, prandaj sërish e potencoj se nuk qëndron ajo që institucionet komunale nuk ju janë dalë në ndihmë familjeve të komitetit jo shumicë në Komunën e Podujevës gjatë kësaj situatë pandemike që jemi, pa dashur të flas për vitet tjera dhe ndihmat tjera, prandaj 160 familje janë vetëm këtë vite që janë ndihmuar, por unë sërish bëj thirrje që të vijin dhe të paraqesin kërkesat e tyre drejtpërdrejtë secili familjarë apo person i komitetit jo shumicë, edhe pse pothuajse Komuna dhe institucionet tjera komunale i kemi informacionet, mirëpo komunikim dhe kontakte kemi me të gjitha lagjet ku jetojnë komunitetet jo shumicë të cilëve ju kam bërë apel që të vijin edhe fizikisht të paraqesin kërkesat dhe nevojat e tyre, por ndoshta më mirë është që të

kontaktohen përfaqësuesit e lagjeve në mënyrë që të mos përfitojnë familje nga dy-tri-katër herë por ndihmat të ndahen sipas nevojave që kanë e jo të anashkalohe familjet me nevojë ndoshta për shkak të mos paraqitjes së kërkesave apo që fizikisht të shkojnë në DSHMS.

Sa i përket çështjes së strehimit është një temë me të cilën jemi ballafaquar me vite e vite, madje në të kaluarën kemi kërkuar nga organet kompetente ndihmë ngase problemet qëndrojnë sa i përket pronës apo destinimit të pronës për çka kemi bërë të pamundurën për të gjet pronë për këtë qëllim edhe përkundër kërkesave të vazhdueshme bërë në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, edhe përmes KPF-së edhe në Kuvend të Komunës por që kjo çështje ka qenë problematike që të bëhet tjetërsimi apo ri destinimi i një prone shoqërore për ndërtimin e shtëpive apo objekteve të banimit për familjet e komuniteteve jo shumicë që kanë nevojë për strehim përveç një mundësi që ende është në proces por që nuk kam informacione se deri ku ka shkuar ajo çështje, fjala është për blerjen e një prone në fshatin Dumosh.

Për familjen Alushi këtu në Podujevë (te stacioni i hekurudhës), edhe përkundër ndihmave të ndryshme të shumta që iu kemi ofruar, unë me vite të tëra jam munduar dhe kam bërë përpjekje për gjetjen e strehimit sepse vërtetë janë familje shumë anëtarsh dhe në gjendje jo të mirë ekonomike sociale por edhe shëndetësore sepse disa prej tyre kanë edhe probleme shëndetësore, por problemi qëndron te prona andaj edhe sot lus dhe bëjë thirrje tek organet kompetente që për atë familje të gjendjet ndonjë mundësi dhe formë për strehim sepse vërtetë ajo familje është në një gjendje më të rëndë që mund të ekzistoj sepse ajo shtëpi është në gjendje të pabanueshme qoftë në aspektin e hapësirës, qoftë të higjienës, ambientit etj.

**Kryesuese e Komitetit**, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, falënderoj parafolësit për informatat dhe kontributin e dhënë lidhur me këtë temë.

### **3. Propozim Plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021**

**znj. Albina Avdiu**, Kryesuese e Komitetit, sa i përket kësaj pike mund të themi se është hartuar një propozim plan i punës të cilin sigurisht keni mund ta shfletoni dhe ta analizoni.

Ky dokument mund të themi se ka ngjashmëri shumë me planin e punës së Komitetit për vitin 2020 që ishte, andaj urdhëroni nëse ndokush ka diçka të shtoj, të heq, të propozoj apo të jap ndonjë vërejtje eventuale lidhur me këtë propozim plan.

**znj. Doruntina Hasani**, theksoi, meqë u cek se ky dokument është i ngjashëm me atë të vitit të kaluar dhe ne jemi në dijeni se në vitin 2020 nuk kemi mund ta përmbushim kënaqshëm planin e punës, bëjë thirrje që në këtë vite t'i përmbahemi planit të punës dhe të vazhdojë punën si Komitet ashtu siç parashihet me plan të punës.

**znj. Albina Avdiu**, Kryesuese e Komitetit, theksoj, falënderoj parafolësen por shpresoj se gjatë vitit 2021 do të mund të mbërrijmë t'i përmbushim dhe ta realizojmë planin e punës. E them këtë duke u mbështetur edhe në faktin që në vitin e kaluar ka qenë një situatë jo e mirë sepse ka qenë fillimi i pandemisë dhe konsideroj se e kemi pasë të pamundur ta realizojmë ashtu siç është, por shpresoj që këtë vite do të bëjmë përpjekje për t'i përmbushur punët dhe aktivitetet që dalin nga plani i punës, atëherë nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë e hedh në votim.

*Kryesuesja e Komitetit konstatoi se njëzëri miratohet plani i punës së Komitetit për Komunitete sipas materialit përkatës*

#### **4. Të ndryshme**

**znj. Albina Avdiu**, Kryesuese e Komitetit

*Pas diskutimeve, si konstatim i përgjithshëm mbështet propozimi që për vizitën komuniteteve jo shumicë të paraparë në muajin e ardhëm të komunikohet mes anëtarëve të Komitetit dhe të dakordohen për datën, kohën dhe çështje tjera përkatëse.*

*Nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesja e Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje*

*Kryesuesja e mbledhjes e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 10:35**

**Procesverbalin e mbajti  
Enis Sheholli**

**Nr. 01-060/04-0033354/21  
Podujevë,  
19 prill 2021**

**Kryesuese e Komitetit  
Albina Avdiu**